



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 12 shkurt 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1227\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 14 paragrafi 6 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Vendimin V\_1075\_2018 të datës 20 dhjetor 2018 për Autorizimit Preliminar të lëshuar shoqërisë "DINO ENERGY" SH.P.K., me të cilën ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC "Lepenci 2", ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Lepenci 2, ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, të datës 19.12.2019 nr. prot. 675/19 të shoqërisë "DINO ENERGY" SH.P.K., me adresë: Magjistralja Prishtinë – Ferizaj, fsh. Konjuh, Lipjan Republika e Kosovës, dhe

**në seancën e mbajtur me datë 12 shkurt 2020 nxori këtë:**

**V E N D I M**

**Për Lëshimin e Autorizimit Preliminar**

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "DINO ENERGY" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Preliminar V\_1075\_2018 i datës 20 dhjetor 2018, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final, për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali "Lepenci 2", ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me **20 qershor 2020**.
- II. Aplikuesit "DINO ENERGY" SH.P.K., obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e



kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga HC "Lepenci 2", ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, gjegjësisht deri me datën **20 qershor 2020** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi

- III. Pas skadimit të afatit të cekur në pikën I. të dispozitivit, Vendimi V\_1075\_2018 i datës 20 dhjetor 2018 për Autorizimin Preliminar, do të shfugizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.

#### Arsyetim

- o ZRRE me datë 13.12.2017 nga shoqëria "DINO ENERGY" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Lepenci 2, ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, Republika e Kosovës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 20 dhjetor 2018 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Preliminar V\_1075\_2018, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- o Vendim për Autorizimin Preliminar V\_1075\_2018, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë "DINO ENERGY" SH.P.K., do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- o Aplikuesi "DINO ENERGY" SH.P.K., me datë 19.12.2019 ka parashtruar kërkesë për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi lëshimin e Autorizimit Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: *arsyeja e vazhdimit të afatit të vendimit mbi autorizimin preliminar është se, me kohë kanë parashtruar kërkesë për tu pajisur me Pëlqim Ujor pranë MMPH-së, i cili organ ende nuk ka kthyer përgjigje për tu pajisur me pëlqim ujor, pavarisht se janë të pajisur me Kushtet Ujore dhe kërkesën e kanë pashtuar me datë 26.02.2019 e që ende nuk kanë pranuar ndonjë përgjigje, përveç procesverbalit për inspektim të kryer me datën 15.10.2019 /INS -27-ESH-PU-82 për shkak të mos pajisjes ende me pëlqim ujor dhe në mungesë të saj është refuzuar edhe kërkesë për tu pajisur me kushte ndërtimore në bazë të Vendimit të dt. 20.11.2019 06 Nr. 351/02-32690/19 të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut. Gjithashtu sa i përket Pëlqimit elektroenergjetik ende nuk e kanë siguruar për arsyet e paraqitura në kërkesën e dt. 14.02.2019 Nr. 116/19 të drejtuar ZRRE-së.*
- o Andaj kanë kërkuar që të shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Preliminar, dhe brenda kësaj periudhe do të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar për autorizim final.



- o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë "DINO ENERGY" SH.P.K., për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i Rregullatorit:**

Arsim Janova, U.D. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Kaçanikut,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së